

Politika e rishikimit të statistikave  
të Bankës së Shqipërisë

Shtator 2017

## I. PËRMBLEDHJE

Transparenca në politikat për rishikimin e statistikave përbën një aspekt të rëndësishëm të qeverisjes së mirë në fushën e statistikave. Standardi i cilësisë së të dhënave<sup>1</sup> thekson rëndësinë e publikimit të politikave lidhur me rishikimin e statistikave të publikuara, në mënyrë që të sigurohet transparencë e plotë për përdoruesit. Cikli i rishikimit duhet të jetë i paracaktuar, relativisht i qëndrueshëm nga viti në vit si dhe duhet të bëhet publik.

[Kalendari i publikimit të statistikave](#) të prodhuara nga Banka e Shqipërisë gjendet në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë dhe ofron informacion mbi datën e publikimit të çdo treguesi statistikor. Këtij kalendari i bashkëlidhet kalendari i rishikimeve, që informon publikun paraprakisht mbi çdo ndryshim të mundshëm të treguesve. Në këtë mënyrë, kalendari i rishikimit është drejtpërdrejt i lidhur me kalendarin e publikimit të statistikave, duke formuar një grup të rëndësishëm informacioni mbi publikimin e treguesve statistikorë.

Cikli i plotë i përpilimit të statistikave në Bankën e Shqipërisë, i cili përfshin publikimin në versionin fillestar të treguesve dhe versionet e rishikuara, synon të ruajë një ekuilibër mes dy dimensioneve kyçe për vlerësimin e përgjithshëm të cilësisë së informacionit statistikor: (i) shpejtësinë e përpilimit; dhe (ii) saktësinë e besueshmërinë. Përpos këtyre dimensioneve, vëmendje i kushtohet përputhshmërisë, në kohë, ndërmjet statistikave me frekuenca të ndryshme përpilimi (ditore, mujore, tremujore, vjetore).

Politika e rishikimeve në Bankën e Shqipërisë ndjek një kalendar të rregullt dhe transparent, ku cikli i rishikimeve është i parapërcaktuar, dhe njëkohësisht është i disponueshëm për përdoruesit. Ajo mbështetet në parimet kryesore të përcaktuara nga Banka Qendrore Evropiane, Kuadri i Vlerësimit të Cilësisë së të Dhënave<sup>2</sup> dhe EUROSTAT, të cilat janë reflektuar në Kodin e Praktikës për Statistikat në Bankën e Shqipërisë.

Në mënyrë të përmbledhur këto parime janë:

- *Rishikimet ndjekin një procedurë racionale*

*Rishikimi i të dhënave statistikore të publikuara më parë është i kufizuar vetëm në ato raste kur shton vlerë materiale në aspektin statistikor.*

- *Rishikimet janë rregullisht të sqaruara*

*Kur seritë statistikore, të botuara më parë janë rishikuar në mënyrë të konsiderueshme, Banka e Shqipërisë shpjegon ndryshimet kryesore të përfshira.*

- *Rishikimet janë të planifikuara*

*Statistikat nën përgjegjësinë e Bankës së Shqipërisë rishikohen në përputhje me kalendarin e publikuar në faqen e internetit të Bankës në fillim të çdo viti.*

Banka e Shqipërisë publikon kalendarin e publikimit dhe të rishikimit të statistikave që ajo përpilon (prezantuar në aneksin bashkëlidhur), mbështetur në një politikë komunikimi proaktive, duke kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimin e përdoruesve të statistikave.

---

<sup>1</sup> Data Quality Assessment Framework, FMN.

<sup>2</sup> Shih shënimin 1.

## II. RISHIKIMI I STATISTIKAVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Si një ndër tre agjencitë statistikore<sup>3</sup> që prodhojnë statistika zyrtare në Republikën e Shqipërisë, Banka e Shqipërisë ka detyrimin ligjor të ofrojë statistika të sakta, të besueshme, të aksesueshme nga publiku i gjerë dhe të krahasueshme me statistikat e tjera zyrtare.

Rishikimi nënkupton çdo ndryshim në statistikat e shpallura për publikun nga një agjenci zyrtare statistikore, duke pasur si objekt kryesor përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të statistikave të prodhuara. Ai konsiston në një përlloraritje të re të një treguesi të publikuar më parë, duke reflektuar ndryshime të mundshme të raportuara në të dhënat *input* në periudhën pas publikimit, korrigjimin e gabimeve të hartimit si dhe përdorimin e një qasjeje të re metodologjike.

Procesi i hartimit të statistikave në Bankën e Shqipërisë mbështetet në informacionin statistikor të mbledhur nga burime të ndryshme të dhënash, që mbulojnë gjithë sektorët institucionalë. Ky informacion vjen nga procese të ndryshme të mbledhjes së të dhënave, që mund të jenë nga raportimi i drejtpërdrejtë i të dhënave sipas formularëve të raportimit ose indirekt, përmes përdorimit të të dhënave administrative për qëllime statistikore.

Kjo shumëllojshmëri burimesh, procesesh të mbledhjes dhe procedurash të hartimit të statistikave është e lidhur me kalendarët e prodhimit dhe publikimit të statistikave, duke zbatuar kërkesat statistikore të organizatave ndërkombëtare. Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë zbaton një sërë procedurash apo praktikash të lidhura me mbledhjen e informacionit statistikor bazë dhe tabelave referencë siç janë ato lidhur me aktivitetin ekonomik dhe sektorët institucionalë, me qëllim krijimin e kushteve të përshtatshme për prodhimin e informacionit statistikor konsistent, me cilësi të lartë dhe në kohë sa më të shkurtër. Si rezultat, hartimi i statistikave bazohet kryesisht në vlerat e raportuara, plotësuar në disa raste me informacion të vlerësuar - sipas tipit të statistikave dhe afateve kohore të tyre - të cilat në mënyrë të natyrshme janë subjekt rishikimesh, për shkak të përfshirjes së informacionit të ri që mbledhet përtej një periudhe të caktuar kohore ose të korrigjimeve të gabimeve apo mungesave në burimet e të dhënave, të cilat publikohen sipas kalendarit.

Me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të procesit të hartimit të statistikave dhe të cilësisë së statistikave, si dhe rritjes së besueshmërisë së publikut ndaj tyre, Banka e Shqipërisë synon marrjen e informacionit sa më të saktë nëpërmjet rritjes së frekuencës në mbledhjen e të dhënave, përmirësimin e metodave të kontrollit të cilësisë së të dhënave dhe përmirësimin e procedurave të vlerësimit për rastet e mungesës së të dhënave (të përgjigjeve) ose të pamjaftueshmërisë (të papërshtatshmërisë) së tyre. Në këtë mënyrë, synohet minimizimi i rishikimeve, duke i kufizuar ato në situata ku rishikimet kanë vlerë të shtuar materiale, pavarësisht mundësisë për kryerjen e rishikimeve *ad hoc* jashtë kalendarit.

Publikimi i statistikave të rishikuara shoqërohet në mënyrë të rregullt me njoftime statistikore, të cilat shpjegojnë ndryshimet kryesore të rezultateve. Statistikat nën përgjegjësinë e Bankës së Shqipërisë rishikohen sipas një kalendari publikimesh dhe rishikimesh të standardizuar, koherent, në dispozicion të publikut, i cili u siguron përdoruesve

<sup>3</sup> Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 "Për statistikat zyrtare" si dhe Programi i Statistikave Zyrtare.

informacion mbi shpeshësinë e publikimeve, datat e kalendarit si dhe periudhat referencë për publikimin dhe rishikimin e statistikave përkatëse.

Ky kalendar reflekton politikën evropiane mbi rishikimet e rregullta<sup>4</sup>, të cilat duhet të ndodhin me periodicitet vjetor, tremujor dhe mujor, për t'iu përshtatur mënyrës së rishikimeve të llogarive kombëtare vjetore e tremujore si dhe politikës përkatëse të publikimit të statistikave. Rishikimet e statistikave mujore janë pjesë e një strategjie të përgjithshme që të sigurojë koherencë midis të gjithave statistikave të publikuara në të njëjtën periudhë. Kështu, sipas propozimit evropian, kur në tremujorin e parë T të vitit V, raportohet për herë të parë informacion për tremujorin e katërt të vitit V-1, mund të rishikohen tremujorët e tjerë të vitit V-1 (3T), si dhe të gjithë tremujorët e tre viteve të mëparshme V-2 (4T), V-3 (4T), V-4 (4T) dhe V-5 (4T) me një maksimum prej 20 tremujorësh.

Politika e rishikimit të statistikave të Bankës së Shqipërisë publikohet në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë, në “rubrikën” statistika.

---

<sup>4</sup> Rekomandim i CMFB (Committee on Monetary, Financial and Balance of Payments Statistics) në korrik të vitit 2012, si dhe manualit të rishikimit të statistikave të EUROST-it <http://ec.europa.eu/eurostat/en/web/products-manuals-and-guidelines/-/KS-RA-13-016>.

KALENDARI I PUBLIKIMIT DHE RISHIKIMIT TE STATISTIKAVE TE BANKES SE SHQIPERISE

ANEKS - KALENDARI I PUBLIKIMIT DHE RISHIKIMIT TË STATISTIKAVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

	Kategoria e të dhënave	Periodiciteti	Datat e publikimeve*	Periudha referencë** për publikim**	Periudha nën rishikim	Shënime	
Statistika të kursit të këmbimit	Kursi i këmbimit	Ditor	çdo ditë pune	Ditë kalendarike	n.a		
	Kursi mesatar i këmbimit	Mujor	Janar	Janar (V)			
	Kursi i këmbimit në fund të periudhës		Shkurt	Shkurt (V)			
			Mars	Mars (V)			
			Prill	Prill (V)			
			Maj	Maj (V)			
			Qershor	Qershor (V)			
			Korrik	Korrik (V)			
			Gusht	Gusht (V)			
			Shtator	Shtator (V)			
			Tetor	Tetor (V)			
			Nëntor	Nëntor (V)			
Dhjetor		Dhjetor (V)					
Statistika të rezervës ndërkombëtare	Mjetet e rezervës	Mujor	Janar	Dhjetor (V-1)	n.a		
			Shkurt	Janar (V)			
			Mars	Shkurt (V)			
			Prill	Mars (V)			
			Maj	Prill (V)			
			Qershor	Maj (V)			
	Template-i i rezervës ndërkombëtare		Korrik	Qershor (V)			
			Gusht	Korrik (V)			
			Shtator	Gusht (V)			
			Tetor	Shtator (V)			
			Nëntor	Tetor (V)			
			Dhjetor	Nëntor (V)			
Statistika të sistemeve të pagesave	Statistika të sistemeve të pagesave	Mujor	Janar	Nëntor (V-1)	n.a		
			Shkurt	Dhjetor (V-1)			
			Mars	Janar (V)			
			Prill	Shkurt (V)			
			Maj	Mars (V)			
			Qershor	Prill (V)			
			Korrik	Maj (V)			
			Gusht	Qershor (V)			
			Shtator	Korrik (V)			
			Tetor	Gusht (V)			
		Nëntor	Shtator (V)				
		Dhjetor	Tetor (V)				
		Tremujor	Mars	T4 (V-1)	n.a		
			Qershor	T1 (V)			
Shtator	T2 (V)						
Dhjetor	T3 (V)						
Statistika të korporatave depozituese	Bilanci sektorial dhe paraqitja monetare e Bankës Qendrore	Mujor	Shkurt	Dhjetor (V-1); Janar (V)	n.a	Rishikime në periudhën paraardhëse mund të kryhen mbështetur në politikën e rishikimit. Rishikimet materiale shoqërohen me shënime të vecantië	
			Mars	Shkurt (V)			
			Prill	Mars (V)			
			Maj	Prill (V)			
			Qershor	Maj (V)			
			Korrik	Qershor (V)			
			Gusht	Korrik (V)			
			Shtator	Gusht (V)			
			Tetor	Shtator (V)			
			Nëntor	Tetor (V)			
	Dhjetor	Nëntor (V)					
	Agregatët monetarë	Mujor	Shkurt	Dhjetor (V-1); Janar (V)	n.a		
			Të dhëna të korporatave depozituese	Mars			Shkurt (V)
			Depozitat e përfshira në paranë e gjerë	Prill			Mars (V)
			Kredia për ekonominë	Maj			Prill (V)
			Depozitat	Qershor			Maj (V)
			Huatë	Korrik			Qershor (V)
			Normat e interesit	Gusht			Korrik (V)
				Shtator			Gusht (V)
				Tetor			Shtator (V)
Nëntor				Tetor (V)			
Dhjetor	Nëntor (V)						
Depozitat sipas qarkut	Tremujor	Shkurt	T4 (V-1)	n.a			
		Maj	T1 (V)				
		Korrik	T2 (V)				
		Tetor	T3 (V)				
Huatë sipas qarkut	Tremujor	Shkurt	T4 (V-1)	n.a			
		Maj	T1 (V)				
		Gusht	T2 (V)				
		Nëntor	T3 (V)				
Bilanci sektorial i shoqërive të kursim-kreditit	Tremujor	Shkurt	T4 (V-1)	n.a			
		Maj	T1 (V)				
		Gusht	T2 (V)				
		Nëntor	T3 (V)				
Treguesit e Shwudetit Financiar	Mujor	Shkurt	Dhjetor (V-1); Janar (V)	n.a			
		Mars	Shkurt (V)				
		Prill	Mars (V)				
		Maj	Prill (V)				
		Qershor	Maj (V)				
		Korrik	Qershor (V)				
		Gusht	Korrik (V)				
		Shtator	Gusht (V)				
		Tetor	Shtator (V)				
		Nëntor	Tetor (V)				
		Dhjetor	Nëntor (V)				
		Të dhëna të pasqyrave financiare të bankave	Tremujor		Shkurt	T4 (V-1)	n.a
					Maj	T1 (V)	
					Gusht	T2 (V)	
			Nëntor	T3 (V)			

Statistika të sektorit të jashtëm	Bilanci i pagesave	Tremujor	Mars	T4 (V-1)	T1, T2 dhe T3 për vitin V-1
	Borxhi i jashtëm bruto		Qershor	T1 (V)	T1, T2 dhe T3 dhe T4 për vitin V-1
			Shtator	T2 (V)	T1 i vitit V dhe çdo tremujor për vitet V-1, V-2, V-3, V-4, V-5
			Dhjetor	T3 (V)	T1 dhe T2 për vitin V
	Statistika të pozicionit të Investimeve ndërkombëtare	Tremujor	Mars	T4 (V-1)	T1, T2 dhe T3 për vitin V-1
	Pozicioni i investimeve direkte sipas shtetit dhe aktivitetit ekonomik		Qershor	T1 (V)	T1, T2 dhe T3 dhe T4 për vitin V-1
	Fluksi i investimeve direkte sipas shtetit dhe aktivitetit ekonomik		Shtator	T2 (V)	T1 i vitit V dhe çdo tremujor për vitet V-1, V-2, V-3, V-4, V-5
			Dhjetor	T3 (V)	T1 dhe T2 për vitin V

\* Kalendar i publikimit të statistikave është i shpallur në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë, në rubrikën statistika

\*\* Shënimi "T" qëndron për muajin tremujor, V për vitin aktual dhe V-1 për vitin e mëparshëm.